



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AKADEMIA E SHKENCAVE**  
**KRYESIA**

Tiranë, më 23.10.2023

**Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës**

**Të dashur kolegë të Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës,**

**Me dhimbje të thellë në zemër mësuam për largimin e papritur dhe të parakohshëm nga jeta të akademikut Luan Mulliqi; një nga mjeshtrat më cilësorë dhe më gjurmëlënës në artin e skulpturës dhe pikturës moderne të Kosovës; veprat e të cilit, të ekspozuara në shumë vende të Botës, morën çmime dhe vlerësime të larta për origjinalitetin dhe risitë e tyre brenda dhe jashtë vendit.**

**Arti i tij i veçantë; përmendoret e vendosura në sheshe qytetesh e institucione; tablotë frymëzuese që mbajnë emrin e tij dhe gjenden në mjedise ndërkombëtare të niveleve të larta, janë pasqyrë e një shpirti të frymëzuar prej vlerash të larta njerëzore.**

**Patëm kënaqësinë që, ndonëse për një kohë të shkurtër, ta njohim për së afërmi personalitetin e Luan Mulliqit, i cili iu bashkua me vullnet e përgjegjësi nismave tona të përbashkëta në albanologji, duke shprehur me këtë rast një vetëdije shkencore e krijuese të admirueshme, që do të shërbejë gjithnjë si referencë intelektuale e morale për të gjithë ne.**

**Në këto çaste të rënda trishtimi ndajmë me ju dhimbjen tonë të thellë vëllazërore për këtë humbje të pakthyeshme, që la mes jush e nesh një boshllëk të madh. Lutemi i përcillni familjes së tij dhe bashkësisë akademike e artistike të Kosovës ngushëllimet tona të thella.**

**Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.**